



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5755 prot.

Himarë, më 11.08.2026

VENDIM

Nr. 44, Datë 30.07.2026

PËR
“VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK NË
KUADËR TË PROJEKTIT
“NDËRTIM & RIKUALIFIKIM I RRUGËS PARALELE ME RRUGËN E PLAZHIT,
BORSH ”

Mbështetur në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe VKM-në nr. 408/2015 (i përditësuar me anë të VKM nr.377/2024) “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” (i përditësuar); Me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 30.07.2026, miratoi me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Miratimin e vijimit të procedurave për shpronësim për interes publik në kuadër të projektit “Ndërtim & Rikualifikim i Rrugës Paralele me Rrugën e Plazhit, Borsh”, sipas hartës dhe gjurmës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Kryetari dhe administrata e Bashkisë Himarë për vazhdimin e procedurave të shpronësimit për interes publik në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, deri në miratimin e aktit normativ të shpronësimit për interes publik.
3. Vlera financiare paraprake e shpronësimit për pronat që preken nga projektit “Ndërtim & Rikualifikim i Rrugës Paralele me Rrugën e Plazhit, Borsh”, do të përballohet nga Buxheti i Bashkisë Himarë.



4. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes sektorëve teknikë dhe urbanistikës, për përgatitjen, plotësimin dhe administrimin e të gjithë dokumentacionit teknik dhe ligjor të nevojshëm për vijimin e procedurave të shpronësimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes njësive të komunikimit, për komunikimin dhe informimin e publikut, të kryejë publikimin e këtij vendimi dhe të dokumentacionit përkatës, si dhe të informojë subjektet e interesuara dhe publikun, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
7. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj



SHKALLE: 1:5000



MIRATOHET

Z. VANGJEL TAVO
KRYETARI I BASHKISE

INFORMACION TE NDRYSHME TE PROJEKTTIT
EMERTIMI I PUNIMEVE : KERKESE PER NDERTIM TE R
LLOJI I STRUKTURES : --
ZHVILLUESI : --
PRONARI : --
ADRESA : BORSH -- HIMARE

PARAMETRAT URBANE HIUB 20.454	SIPAS PLANIT
SIPERFACE E TOKES QE ZHVILLOHET	13208 m ²
LARTESIA E OBJEKTIT	--
NUMRI I KATEVE	--
VENDET PER PARKIM	--
KOEF SHFRYT. TERRITORI	--
INTENSITET NDERTIMI	--

PARAMETRAT URBANE TE PRONES	
SIPERFACE TOTALE E PRONES QE	--
SIPERFACE NDERTIMI NENTOKE	--
SIPERFACE MBI TOKE	--
SIPERFACE TOTALE NDERTIM (nenteke dhe mbitoke)	--
SIPERFACE PISHINE	--
NUMRI I KATEVE	--
KOEF SHFRYT. TERRITORI	--
INTENSITET NDERTIMI	--

TREGUESIT E DISTANCAVE (NE METRA)	
NGA KUFINJUTE E PRONES	--
NGA STRUKTURAT TE TJERA	--
NGA RRJETI RRUGOR, (AKSIJ)	--

TE DHENAT MBI PROJEKTUESIT					
PROJEKTUES	Nr. LIC.	FIRMA	ARKITEKTURA	Nr. LIC.	FIRMA
NET-GROUP SH.P	KN.6830/17	Emri i firmës Llogarëdhënësi		—	—